
PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

“Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2.a)”

“Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart”

“Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart”

(Ndryshim I kushteve të lejes mjedisore të tipit B me PN-4820-03-2017)

Vendodhja: Shkallnur, Shkambi i Kavajes, Qarku Durrës.

Kërkues: Subjekti: “RADA OIL INDUSTRY” shpk

Korrik, 2022

PASQYRA

KAPITULLI I

- 1.1 Hyrje
- 1.2 Te pergjithshme
- 1.3 Profili i Kompanise

KAPITULLI II

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 2.1 Qellimi i projektit
- 2.2 Vendndodhja
- 2.3 Te dhena mbi projektin

KAPITULLI III PERSHKRIMI I

MJEDISIT

- 3.1 Karakteristikat e pergjitheshme te mjedisit natyror

KAPITULLI IV

MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

- 4.1 Toka
- 4.2 Demtim i flores dhe faunes
- 4.3 Demtim i tokes nga erozioni
- 4.4 Masa per rigjenerimin e peisazhit
- 4.5 Masat e ndihmes se pare

KAPITULLI V

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- 5.1 Konkluzione

1.1 Hyrje

Subjekti “RADA OIL INDUSTRY” sh.p.k, i pajisur me numër NIPT-i: L21410501A, me seli në Durrës, Xhafzotaj, XHAFZOTAJ, Xhafzotaj, Shijak, pranë tregut rural, me administrator z. Plarent Gjinari, ushtron aktivitetin “Grumbullim, transportim dhe depozitim i mbetjeve të ngurta dhe vajore, Asgjesim i vajrave të përdorur përveç incinerimit ose lëndfillimint, Stacion Transferimi për mbetje të rrezikshme”, me vendndodhje Shkallnur, Shkëmbi i Kavajes, Qarku Durrës.

Për ushtrimin e këtij aktiviteti subjekti “RADA OIL INDUSTRY” sh.p.k është pajisur me leje mjedisore të tipit B me të dhënat e mëposhtëme:

PN-4820-03-2017, Nr. 2682 Prot, datë 03.03.2017, K.Nr. 06, Nr. I identifikimit të lejes 2542

Me rritjen e kontratave të bashkëpunimit me subjekte të licensuara për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme rrjedhimisht është shtuar edhe gama e mbetjeve të cilat do të menaxhohen nga subjekti jonë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Rritja e numrit të kontratave të bashkëpunimit si edhe rritja e gamës së mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme rrjedhimisht sjell edhe rritjen e kapacitetit menaxhues të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të instalimit.

Gjithashtu duke ju referuar kontratave të bashkëpunimit që subjekti ynë ka nënshkrur në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, një pjesë e gamës së mbetjeve sipas Vendimit nr 402, datë 07.07.2021 “Per Miratimin e Katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme dhe një pjesë të rrezikshme për të cilën lind nevoja e shtimit të aktivitetit:

- **Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme.**
- **Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.**

Kapaciteti ditor i këtij stacioni transferimi për mbetjet të rrezikshme parashikohet të jetë më i madh se 10 ton/ditë

Kapaciteti ditor i këtij stacioni transferimi për mbetjet jo të rrezikshme parashikohet të jetë më i madh se 60 ton/ditë.

Si rrjedhim i ndryshimeve të bëra në instalim si:

- Shtimi i gamës së mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
- Rritja e kapacitetit menaxhues të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
- Shtimi i aktivitetit “Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme” me kapacitet më të madh se 10 ton/ditë;
- Shtimi i aktivitetit “Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme” me kapacitet më të madh se 60 ton/ditë;

Rrjedhimisht kërkohet edhe reflektimi i ndryshimeve të instalimit në lejen mjedisore me PN-4820-03-2017, Nr. 2682 Prot, datë 03.03.2017, K.Nr. 06, Nr. I identifikimit të lejes 2542.

Në menyrë të përmbledhur ndryshimet e instalimi / lejes mjedisore me PN-4820-03-2017, Nr. 2682 Prot, datë 03.03.2017, K.Nr. 06, Nr. I identifikimit të lejes 2542 jepen në tabelën më poshtë:

ISHIN	
Aktiviteti	ID 5.3 – b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2.a).
Kapaciteti	ID 5.3 – b. 10 ton/ditë ose më pak se kaq
Mbetjet menaxhohen në instalim	që në 13 04 01 * Vajra të ndotur anijesh nga lundrimi pranë tokës 13 04 02 * Vajra nga ujëra të zeza të bankinave 13 04 03 * Vajra të ndotur nga lundrime të tjera 13 05 07* Ujë me naftë nga seperatorët ujë/naftë 15 01 01 Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane
BËHET	
Aktiviteti	ID 5.3 – b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2.a). ID 5.10 – a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart. ID 5.10 – b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.
Kapaciteti	ID 5.3 – b. 10 ton/ditë ose më pak se kaq ID 5.10 – a. më I madh se 10 ton/ditë ID 5.10 – b. 60 ton/ditë ose më I madh se kaq
Mbetjet menaxhohen në instalim	që në 13 04 01 * Vajra të ndotur anijesh nga lundrimi pranë tokës 13 04 02 * Vajra nga ujëra të zeza të bankinave 13 04 03 * Vajra të ndotur nga lundrime të tjera 13 05 07* Ujë me naftë nga seperatorët ujë/naftë 15 01 01 Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane KODET E LISTUARA NE ANEKSIN 1 Bashkengjitur kesaj shkrese

1.2 Te pergjithshme

Subjekti i cili do te zhvilloj aktivitetin “Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2.a)”, “Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart” dhe “Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart” është **Rada Oil Industry** i regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me date 10-02-2010 me numer NIPTI **L21410501A** , forma ligjore **SHPK**. Subjekti zhvillon kete aktivitet per Depozitimin dhe seperimin e vajrave te perdorur nga sherbimi I grumbullimit te vjrave, naftes nga autoritetet portuale, duke u mbeshtetur ne eksperiencen e gjate me detin dhe ne sherbimet me mjetet detare.

Qellimi i ketij aktiviteti eshte bazuar ne rendesine e mbledhjes se mbetjeve te naftes ne zonat portuale dhe rendesia mjedisore me standarte bashkohore, per permbushjen e kerkesave te investitorit per projektin qe do te realizohet, pasurite natyrore dhe humane te zones ne studim, si dhe vlerat e vecanta te tyre. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.



Pamje nga Google Earth e Rada Oil Industry

Pasqyra e te dhënave kryesore

Projekti: "Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2.a)"

"Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart"

"Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart"

Me vendndodhje: Ne Shkallnur, Shkambi i Kavajes, Qarku Durrës

Kompania zhvilluese: "Rada Oil Industry" sh.p.k

Siperfaqja e vendit 400 m²

Kapaciteti 4 depozita me nga 200 m³ secila gjithsej **800 m³**

1.3 Profili I kompanise

Rada Oil Industry është një ndërmarrje private, e cila u themelua në vitin 1998 në Durrës.

Me investime të vazhdueshme në logjistikë, pajisje dhe burime njerëzore, ROI është ndër kompanitë më të shquara në Shqipëri, në një gamë të gjerë shërbimesh që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, aktivitetet e portit dhe anijet.

Trajnimi shkencor, arsimi i vazhdueshëm, përvoja afatgjatë e personelit dhe infrastruktura moderne përbëjnë sfondin në të cilin biznesi ynë rritet dhe funksionon çdo ditë.

Kompania ka të gjitha licencat dhe kontratat e nevojshme për të ofruar shërbimet e saj në mënyrën më të sigurt dhe të ligjshme. Në veçanti, sa i përket menaxhimit të mbeturinave, kompania mund të mbledhë, transportojë dhe menaxhojë llojet e mëposhtme të mbeturinave:

- Vajra të përdorura
- Mbeturinat e rrezikshme dhe vajore
- Bateritë dhe akumulatorët e përdorur Mbeturinat jo të rrezikshme

Të gjitha aktivitetet e kompanisë janë të certifikuara sipas standardeve:

- Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001: 2008
- ELOT 1801: 2002 / BS OHSAS 18001: 2007 Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- ELOT EN ISO 14001: 2004 Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

Kompania bashkëpunon me sistemet e çertifikuara të Menaxhimit Alternativ të Mbeturinave, duke mbuluar të gjitha rrjedhat e mundshme (p.sh. mbeturinat e paketimit, bateritë dhe akumulatorët e përdorur, vajrat për lubrifikim të mbeturinave, gomat e përdorura të automjeteve, pajisjet elektrike dhe elektronike të mbeturinave, mbeturinat e ndërtimit, shkatërrimit dhe gërmimeve.

Për më tepër, është anëtare e Shoqatës së Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta dhe Shoqatës Kombëtare të Kompanive të Mbrojtjes së Mjedisit.

Një demonstrim i besueshmërisë dhe vlefshmërisë së fortë të kompanisë konsiderohet çmimi që i është dhënë në vitin 2007 nga Prefektura e Durrësit, në lidhje me praktikën e saj efektive mjedisore dhe shërbimet në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes detare.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Qëllimi i projektit

Qëllimi i aktiviteteve të propozuara është depozitimi dhe seperiimi i vajrave të përdorur nga pastrimi i autoriteteve portuale si edhe menaxhimi i një sere mbetjesh të rrezikshme dhe jo të rresikshme (mbetjet e listuara në Aneksin 1), që të përkrah zhvillimin ekonomik të shoqërisë dhe të përmirësojë gjendjen ekzistuese të lendeve të para si dhe mbrojtjen e mjedisit nga keqmenaxhimi apo mostrajtimi i tyre

2.2 Vendndodhja e zonës së projektit

Vendi i ushtrimit të aktivitetit, është në terren aktual, ku aktualisht ushtron aktivitetin kompania, ambjent i marrë me qera, në zonën e Xhafzotaj pranë tregut industrial. Kjo zonë është me terren të pastër dhe larg resorteve të plazhit, por e mbrojtur dhe e menjauar nga kjo infrastrukturë me ndjeshmëri ndaj ndotjes. Zona nuk është e pyllëzuar dhe e mbushur me gjelbërime të kultivuara nga vetë Subjekti, që e favorizojnë dhe lehtësojnë qenien e këtij objekti dhe aktiviteti hidrokarbur në këtë zonë.



Pamje nga Google e vendit ku ndodhen depozitat

Relievi i zonës është malor dhe dallohet për karakterin kompleks në përbërje të relievit gjejmë: kurrize malore, pllaja, gropa, fusha karstike si dhe lugina.

Siperfaqja e zones ku do të ushtrohet aktiviteti “Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lendfillimit (5.2.a)”, “Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart” dhe “Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart” është **400 m²**.

2.3 Te dhëna mbi projektin

Pershkrimi i linjes teknologjike të depozitave

Shoqëria “RADA OIL INDUSTRY” sh.p.k. është një operator privat që merret me Grumbullimin, seperimin, riciklimin dhe stokimin e mbetjeve të vajrave të përdorura nga anijet në portin e Durrësit. Në vendin ku subjekti në fjalë deshiron të pajiset me leje mjedisore kryen procesin e seperimit, riciklimit dhe atë të **stokimit** të mbetjeve të vajrave. Proceset e tjera kryen në vendodhje të tjera. Objektivi kryesor i shoqërisë është pastrimi e mbetjeve të vajrave të përdorura nga anijet.

Fusha e veprimit është zona portuale. Aktiviteti i pastrimit detar të vajrave të përdorura i kësaj shoqërie, ashtu siç është niveli i trajtimit edhe nga kompani të tjera, do të shoqërohet paraprakisht me depozitimin e vajit të përdorur. Pra, vaji i përdorur i grumbulluar nga anijet në zonat portuale, do të depozitohet në çisterna në Impiantin e Vajrave larg portit detar. Shoqëria në fjalë ka marrë me qera një ambient ky janë të ndërtuara 4 depozita me një kapacitet të përgjithshëm 800 m³. Kjo sasi vaji është perllagaritur nga kontratat paraprake të siguruar dhe pse kompania për depozitimin e vajrave ka marrë me qera dhe 2 depozita të cilat ndodhen në zonën e Xhafzotaj për të cilat sapo është pajisur me Vendim Mjedisor dhe me Leje Mjedisore Tipi B si dhe në këto rast. Zakonisht, këto mbetje vajrash shkojnë për djegie në kaldajat e solarit të impianteve të ndryshme, serra etj. Aktiviteti i pastrimit detar është i fokusuar me shumë në pastrimin e mbetjeve të vajrave të djegur nga anijet, Shoqëria “RADA OIL INDUSTRY” sh.p.k. është një operator privat që kërkon për të investuar për të kryer pastrimin detar nga anijet në port. Aktiviteti shërbimeve detare është rritur shumë duke sjellë rritjen e trafikut detar. Puna në port është zgjeruar me hapa galopante dhe, nevoja për shërbime të tilla pastrimi është akoma dhe me e domosdoshme. Tregu i punës realisht është i siguruar dhe janë planifikuar të kryhen investime për mjete detare dhe makina teknologjike të një cilësie shumë të mirë. Theksojmë se kjo shoqëri po organizon këto shërbime në një nivel të krenarshëm në krahasim me kërkesat ligjore të aplikimit dhe me kompanitë e tjera analoge. Ajo, çfarë do ta dallojë këtë kompani nga ato ekzistueset është se anijet teknologjike të pastrimit detar do të jenë të një standardi teknologjik me të lartë se ato që përdoren aktualisht. Ato janë projektuar për të pastruar ndotjet e detit me hidrokarbure në rastet e emergjencave detare të ndotjes së detit. Në bordin e tyre, ato kanë pajisje të kufizimit të ndotjes në det në një sipërfaqe të konsiderueshme pune dhe, mund të thithin me pompe rreth 300 m³/orë ujë deti të ndotur me hidrokarbure, mund të bëjnë direkt ndarjen e vajrave ose naftës duke depozituar këtë të fundit dhe pastruar ujin e detit. Kjo është përparësia teknologjike e këtyre mjeteve detare të shërbimeve të pastrimit detar edhe në rastet e emergjencash civile me pasoje ndotjen e detit. Aktiviteti i pastrimit detar është një shërbim me procese pune jo të lehta dhe jo komode. Por, është një aktivitet me

ndikime pozitive mjedisore. Si i tillë, ai do të jetë një biznes fitimprurës sepse normalisht planifikohen fonde financiare për pastrimin e mbetjeve të anijeve. Përgjithësisht, këto ishin arsye të fillimeve të aktivitetit. Realizimi i planit të shoqërisë për shërbimin e ofruar do të kalojë në dy faza.

Faza e parë ka të bëjë me riorganizimet e shërbimeve të pastrimit detar në një grup agjencish detare dhe anijesh transporti, sigurimin e kontratave të punës dhe përzgjedhjen e stafit, të cilat janë kryer tashmë.

Faza e dytë korrespondon tani me aplikimet zyrtare të lejeve, investimet për mbetjet detare dhe makinat teknologjike dhe pajisjet e nevojshme për grumbullimin e mbetjeve të anijeve. Ajo ka marrë në përdorim një sipërfaqe toke 400 m² në zonën e Shkallnurit. Depozitat e ruajtjes, seperimit dhe riciklimit të vajit të përdorur dhe makinat teknologjike do të vendosen brenda kësaj sipërfaqeje. Depozitat që subjekti ka marrë me qera janë ekzistuese sepse subjekti ka punuar dhe me parë në këto lloje aktiviteti dhe ka qenë i pajisur me Leje Mjedisore Pa afat që në 2012 po me ligjin e ri ka bërë rishikim i kushteve e meqenese subjekti në fjalë nuk ishte i informuar po e nxjerr lejen si nga e para ku sipas institucioneve kompetente Leja e vjetër do të rifetohet si VNM.

Impianti i Perpunimit të Vajrave të Përdorura i aktivitetit të shoqërisë "RADA OIL INDUSTRY" sh.p.k., do të shërbejë për asgjësimin e mbetjeve të vajrave të përdorura. Më saktë, objekti i Depozitimit dhe Seperimit të Vajrave të Përdorura në Xhafzotaj Durrës do të kryejë rikuperimin për ripërdorim të vajrave të përdorura. Asgjësimi do të bëhet duke përdorur si lëndë djegëse për kaldajat ose për përdorime të tjera si lubrifikant në fabrikat e parafabrikeve të betonit ose, rirafinim nëse është e mundur. Kapaciteti i depozitës totale do të jetë 800 m³. Dy depozita (400 m³) do të përdoren për pritjen e vajrave të papërpunuara (vaj+ujë), ndërsa të tjerat (40 m³) do të përdoren për vajin e rikuperuar.

Vendosja e depozitave të seperimit dhe ruajtjes së vajit të përdorur do të bëhet sipas planimetrisë. Ato do të vendosen në krah të objektit të lavanderisë në mënyrë që të këtu mund të instalimesh lidhese me shkarkimin e autoboteve të vajit. Këto depozita do të jenë pjesë e depove të lëndës djegëse për nevojat e shoqërisë dhe, njëkohësisht pjesë e aktivitetit të shërbimeve të pastrimit detar të shoqërisë "RADA OIL INDUSTRY" sh.p.k. Funkionimi i depozitave si impiant seperimi vaj/ujë konsiston në përdorimin e pajisjeve ndarese që përdoren në anije. Vaji i ndarë nga uji pompohet në depozitën e ruajtjes dhe konsiderohet i rikuperuar, gati për t'u përdorur si lëndë djegëse për kaldajat, serat etj. Ndërsa uji, përpara se të derdhet në sistemin e kanalizimeve të zonës pranë, derdhet në një gropë emergjence e cila në vetvete përben një gropë seperatore të ngjashme me atë që përdoret në teknologjinë e karburanteve. Ndarja vaj/ujë në gropën seperatore bëhet sipas peshës specifike ku vaji qëndron lart, ndërsa uji qëndron poshtë i cili kalon me sifon në tubacionin e shkarkimit në terren. Kuptohet që shtresa e vajit që mbetet në gropën seperatore është e vogël, prandaj ai qëndron në gropën e mbushur në nivelin që as nuk derdhet dhe as nuk arrin tek shkarkimi i sifonit të ujit. Kur në këtë gropë grumbullohet një sasi vaji e matshme, ajo merret me enë të veçanta ose me pompe dhe futet në depozitën e vajrave të përdorura të sapo ardhura nga anijet.

Të dy depozitat e vajit vendosen mbi një bazament beton-arme të modeluar në formën e një vaskë të madhe. Në rast të ndonjë defekti në instalimet hidraulike ose të ndonjë gabimi njerëzor, vaji që mund të derdhet mbetet brenda kësaj vaskë. Kjo është mënyra më e mirë për të mbrojtur truallin tokësor dhe detin nga ndotja me

hidrokarbure. Kjo është zgjidhja emergjente me e mire e cila lehtëson punën dhe kostot e pastrimit me pas.

Përshkrimi i projektit teknologjik

Aktiviteti i pastrimit detar do të përmbaje (në parim) tre linja teknologjike:

- Linja e grumbullimit dhe largimit të vajrave të përdorura të anijeve.
 - Linja e përpunimit ose seperimit të vajrave të përdorura të anijeve.
 - Linja e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta të anijeve.
- **Linja e grumbullimit dhe largimit të vajrave të përdorura të anijeve**

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të vajit të përdorur nga anijet, behet kryesisht në mol pasi anija të jetë ankoruar por edhe në radë. Për këtë qëllim përdoren anijet teknologjike dhe sistemet e thithjes dhe pompimit të vajit. Ngarkesa e vajit që duhet ndërruar nga anijet, kalon në çisternat e anijes pastrimit kur ky shërbim kryhet në radën e portit. I njëjti proces kryhet edhe kur kryhet pastrimi i sipërfaqes së detit të ndotur me hidrokarbure gjatë ndonjë emergjence detare me pasoje ndotjen e detit. Në këtë rastin kur ky shërbim kryhet në ndonjë nga kalatat e portit, vihet në përdorim sistemi portativ i pompimit dhe vajrat e përdorura depozitohen direkt në autobote, të cilat mund të largojnë menjëherë të gjithë ngarkesën e tankut të anijes apo tragetit. Kjo ngarkesë mund të arrijë edhe 6-10 ton vajra të përdorura nga një anije. Vaji i përdorur i ngarkuar në autobote, transportohet për në depozitat e ruajtjes dhe seperimit të tij pranë Xhafzotaj është vendqëndrimi dhe selia e shoqërisë "RADA OIL INDUSTRY" sh.p.k. Autobotet me kapacitete të konsiderueshme, të gatshëm për të pritur nga anijet vajrat e përdorura në sasia të mëdha, qëndrojnë në pritje të parkuar në port. Në përgjithësi vajrat e përdorura të anijeve kanë një përmbajtje uji rreth 10 %. Normalisht uji i pranishëm vjen nga shtyrja dhe më pas shpërfaqet që i bëhet tubacioneve që shërbejnë për dërgimin e vajit të djegur nga anija në autoçisternen e firmës pastruese. Pastrimi i detit nga ndotjet me hidrokarbure, parashikohet për here të pare nga aktiviteti i shërbimeve të shoqërisë "RADA OIL INDUSTRY" sh.p.k. Ky është rasti i parashikuar në emergjencat detare me pasoje ndotjen e detit me hidrokarbure në përgjithësi (nafte dhe vajra). Shoqëria në studim që e propozon këtë shërbim ka planifikuar investimin për blerjen e këtij mjeti detar pastrimi. Ky tip anije do të shoqërohet me pajisjet e kufizimit të ndotjes nepermjet grumbullimit të hidrokarbureve me ane të disa notuesëve të gjatë që ngrihen disa centimetra mbi sipërfaqen e ujit. Këto kufizues të ndotjes mund të tërhiqen nga anija duke rrethuar zonën e ndotjes që të mos shpërndahen hidrokarburet në sipërfaqe të gjera ose të kalojnë në breg. Në këtë mënyrë, ndotja me hidrokarbure mbi sipërfaqen e ujit të detit izolohet brenda një rrethi të mbyllur. Në këtë moment, vihet në punë një sistem pompimi shumë i fuqishëm me pompa zhytëse, të cilat thithin një volum vaj/ujë prej 300 m³/h. Pompat janë të lidhura me një pajisje seperimi që ndan direkt ujin e detit me hidrokarburet, duke lënë të lirë ujin e detit dhe duke grumbulluar në depozitën e anijes ndotesin. Ky, është së pari një investim i rëndësishëm për mbrojtjen e detit dhe zonës portuale nga ndotjet me hidrokarbure. Dhe, së dyti, është një kapacitet teknologjik që do të plotësojë infrastrukturen portuale të shërbimeve të pastrimit në raste të emergjencave detare.



Kufizues te ndotjes



Mjete thithese te vajrave

- **Impianti i depozitimit dhe seperimit te vajrave te perdorura**

Eshte nje linje e thjeshte teknologjike per largimin perfundimisht te ujit, homogjenizimin e te gjitha fraksioneve te renda te hidrokarbureve dhe perftimin e nje produkti te pershtatshem per t'u perdorur si lende djegese ne kaldaje. Ky produkt ka veti perafersisht te solarit dhe perdoret si lende djegese ne kaldajat e solarit te impianteve te ndryshme. Kapaciteti depozitues i hidrokarbureve do te jete 800 m³. Në përbërje të Impiantit te Perpunimit te Vajrave te Perdorura është edhe **“Separatori i ndarjes vaj/ujë”**. Ajo është nje pajisje kompakte, e vogel që vendoset ne sheshin pranë depozitave të vajrave të perdorura. Pas çdo furnizimi që vjen nga porti me autobot apo nga çdo furnitor tjetër, kjo pajisje ndarëse e vajit nga uji vihet në punë për perpunimin e vajrave te perdorura. Procesi i perpunimit të vajrave të përdorura në këtë impiant kalon në këto faza:

- Depozitimi ne çisternen pritese te vajit te papërpunuar të vajrave të transportuara me autoçisternë, për të realizuar ndarjen e parë të vajrave nga uji për efekt të ndryshimit të densiteteve të lengjeve dhe kohës së qëndrimit në depozitë.

- Kjo çisternë ka nje rubinet ne fundin e saj, me anen e te cilit behet largimi i ujit qe eshte ne pjesen fundore te depozites. Në këtë fazë bëhet ndarja paraprake e hidrokarbureve nga ujit në shkallën 97 %.

- Uji i seperuar në këtë mënyrë nga vajrat e përdorura, kalon në gropen emergjente (ose gropa seperatore), ku grumbullohet dhe lihet në qetësi për një përpunim të mëtejshëm.

- Vaji qe gjendet ne depozitën pritëse, pasi i është larguar pjesa me e madhe e ujit (rreth 97 %), kalon per ne seperatorin e vajit. Me anen e seperatorit realizohet largimi i fraksioneve te mbetura te ujit deri ne shkallën 99.5 %. Vaji i pastruar nga mbetjet ujore kalon direkt në depoziten e ruajtjes dhe është i gatshëm për përdorim si lëndë djegëse në kaldajat e impianteve te ndryshme, serave dhe përdorime te tjera.

- Fraksioni i ujit të përftuar nga seperatori kalon për depozitim në gropen seperatore te ujrave. Me kalimin e kohës edhe në këtë gropë emergjente, ndodh fraksionimi i pjesës së vajrave i cili gjendet ne sasine më pak se 3 % vaj në volum nga uji, duke u vendosur në pjesen e sipërme të gropes seperatore.

- Kjo sasi thithet me pompë dhe kalohet perseri në depoziten pritese për t'ju nënshtruar përsëri procesit të seperimit dhe përpunimit të mëtejshëm. Në këtë mënyrë kjo procedurë përsëritet gjithmonë për ujrak e seperimit.

- Kjo skemë përpunimi me disa faza dhe me riqarkullim disa herë të ujrave, siguron cilësi të ujrave për shkarkim si dhe cilësi të vajrave për t'u ripërdorur si lëndë djegëse.

- Shkarkimet ndotëse qoftë në pikën e grumbullimit në port, ashtu edhe në impiantin e përpunimit të vajrave të përdorura janë plotësisht të eliminuara. Teknikisht ky problem është zgjidhur që në projekt.

- Linja e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta të anijeve

Theksojmë që në fillim se mbetjet e ngurta ose plehrat e natyrës urbane do të grumbullohen nga anijet të ambalazuara në thasë të zinj dhe, dërgohen me automjete teknologjike plehrash në Sheshin e Mbetjeve Urbane të Bashkisë Durrës. Trajtimi i mbetjeve të ngurta të anijeve do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr.8094, datë 23.01.1996 "Pë Largimin Publik të Mbeturinave" dhe Ligjin Nr.10463, datë 22.09.2011 "Per Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" I ndryshuar.

Teknologjia e pastrimit të ujrave të përdorimit jetësor në anije, parashikon dezinfektim të tyre menjëherë me klor aktiv në autobus, direkt në mol. Pastaj ato do të transportohen për në Kolektorin Kryesor të Ujrave të Zeza të Qytetit deri sa të vihet në funksionim impianti i trajtimit të ujrave të zeza të qytetit.

Sacioni i Transferimit të Mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme

Subjekti do të kryejë grumbullim, transport, magazinim dhe trajtim të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme të listuara në aneksin 1 bashkëngjitur këtij dokumenti.

Proceset që do të zhvillohen për diferencimin e mbetjeve urbane të grumbulluara duke prodhuar lende të përdorueshme janë të ndara sipas këtyre hapave:

- Peshimi i mjeteve të cilat transportojnë mbetjet.
- Shkarkimi i mbetjeve në Stacionin e transferimit.
- Seleksionimi kur është e nevojshme dhe paisja e mjeteve me flet-dalje, ku pasqyrohet dhe sasia e mbetjeve të shkarkuara.
- Magazinimi i perkoheshëm i mbetjeve
- Trajtimi i mbetjeve të vajrave, naftës me ane të procesit të seperimit
- Transporti i mbetjeve të tjera drejt operatoreve të tjerë të licensuar për menaxhimin e mbetjeve me të cilët subjekti RADA OIL INDUSTRY bashkëpunon.

PERSHKRIMI I MJEDISIT

3.1 Vleresimi i tij (Mjedisit)

Burimi kryesor per çlirimin e gazeve pritete jete nga automjetet e transportit pra nga autocisternat. Lendet e çliruara ne ajer perfshijne monoksidin e karbonit (CO), Hidrokarbure aromatike policiklike (PAH), perberje organike si benzeni, tolueni etj., Dioksid squfuri, si dhe aroma te tjera te pakendshme.

Informacioni qe na eshte siguruar perreth projektit te depozitave dhe seperimit te vajit te perdorur nga autoriteti portual dhe informacioneve te monitorimit, eshte perdorur nje studim i shpendarjes sasiore ne ajer per te vleresuar efektet potenciale ne ajer nga projekti i propozuar. Gjate ketij studimi jane perdorur si inpute te dhena dhe vleresime te modelit CALPUFF.

Efektet e ndotesve te ajrit jane vleresuar duke perdorur informacionin e mbledhur nga monitorimi i bere nga Zyra sherbimi analoge te Mjedisit dhe Pasurive.

Rezultatet e ketij vleresimi jane bere sipas kriterëve te OEH, per te arritur nje vleresim sa me te sakte. Bazuar ne keto rezultate, clirimi i ndotesve ne ajer pritete jete minimal dhe jo i demshem per cilesine e tij. Gjithashtu, clirimi i pluhurave gjate transportit te lendes se pare pritete jete i ulet dhe i kontrollueshem, fale masave te marra dhe te zbatuara gjate procesit.

MASAT PAR EVITIMIN APO ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ne kemi pranuar sfida qe lidhen me mbrojtjen e mjedisit, bashke ne premiset e tij dhe mbrojtjen e mjedisit te vendit. Duke qene nje industri e madhe ne Shqiperi, ne jemi nje kercenim per ekologjine duke rrezikuar gjendjen e ajrit dhe tokes. Me hyrjen ne BE, ne duhet te perputhemi me normat e IPPC (Direktivat e Integruara te Kontrollit te Parandalimit te Ndotjes) Kompania ne nje menyre te planifikuar dhe te dokumentuar, do te zbatoje kerkesat e kerkuara nga keto direktiva.

Zbatimi i standarteve te mbrojtjes se mjedisit perfshin nje teresi aktivitetesh dhe koordinimesh te mjaftueshme, si dhe ndryshimet ne perceptim, me qellim qe te arrihen standartet e kerkuara. Nje grup menaxheresh, inxhinieresh dhe punetoresh te tjere nga sektore te ndryshem kane punuar ne implementimin e EMS qe prej vitit 2008.

Si nje nevojshmeri per standartin, grupi tashme duhet te perputhet me Ligjin per Mjedisin qe ka si "mision" mbrojtjen e mjedisit. Ky ligj pranon pergjegjshmerine e kompanise per te depozituar mbetjet vajore qe vijne nga pastrami detar Durres, duke mbrojtur njekohesisht mjedisin. Inxhinieret thone "Ne e kuptojme qe veprimet tona kane ndikime te pashmangshme ne mjedis. E kemi per detyre qe t'i pakesojme sa me shume qe te jete e mundur keto efekte, si dhe te permiresojme ne menyre te vazhdueshme performancen tone".

Ne veme ne praktike nje numer parimesh ne perputhje me te gjitha legjislacionet, rregullat dhe lejet e aplikueshme te mjedisit dhe ne raste te vecanta qe i kane arritur qellimet. Ne do vazhdojme perpjekjet tona per te kontrolluar dhe pakesuar ndotjen dhe per te arritur objektiva te qarta dhe te matshme te mjedisit. Grupi gjithshtu po angazhohet qe te reduktoj energjine e konsumuar si dhe humbjet gjate transportit, gjersa kerkon te reduktoj konsumimin e materialeve ne te gjitha operacionet, riperdorimin dhe per te ndihmuar ne riciklimin e tyre. Kompania gjithshtu po promovon perdorimin e praktikave te miremenaxhimit te mjedisit nga kontraktuesit dhe furnizuesit e tij, nepermjet nje marreveshjeje te qendrueshme se bashku me suportin e vazhdueshem ndaj grupeve, nepermjet Karteles se Pergjegjshmerise Sociale te Kompanise, per te mbrojtur mjedisin si dhe te zhvilloje nje marredhenie te qendrueshme me komunitetin lokal.

4.4 Masat për rigjenerimin e peisazhit;

Per regjenerimin e pejsazhit jane marre masa dhe eshte parashikuar projekt i veçante per te. Me fondet qe do te depozitohet subjekti per garanci rehabilitimi regjenerimi i pejsazhit do te rregullohet. Gjate punes, nuk do te kete ndotje te çfaredo lloji te zones. Mbas shfrytezimit, eshte planifikuar marrja e masave dhe shpenzimet perkatese per rigjenerimin e mjedisit dhe rregullimin e pejsazhit. Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytezimit te depozitave konsistojne ne:

1. Krijimin e siperfaqeve per mbjellje;
2. Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane pemesh te zones dhe barishte te ndryshme;
3. Mirmbajtjen e siperfaqeve te mbjella;

4.5 Masat e ndihmës së pare

Në rast të thithjes së avujve paraqitet iritimi i hundës dhe fytit, pra kollitja. Largimi në ajër të i pastër, e në rast të komplikacioneve të jepet ndihma e parë, e pastaj të kërkohet ndihma mjekësore.

5.1 Konkluzione

- Me e rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti Paraparak te VNM- se eshte se ai do ti vije ne ndihme mbrojtjes se mjedisit
- Teritori i Rada Oil Industry nuk ka ndonje status te veçante qe pengon punimet ne kete aktivitet.
- Me masat qe do te merren aktiviteti nuk do te kete ndikime negative ne toke dhe nuk do te ndikojne ne ujrat sipërfaqesore e nentokesore.
- Hartimi dhe zbatimi i projektit te Grumbullim, transportim dhe depozitimi, seperimit dhe asgjесimit per vajrat e perdorur qe vijne nga pastrami detar Durres nuk do te kete ndonje pasoje negative te mundeshme ne mjedisin e zones mbasi objekti eshte vendosur ne nje teren pa ndonje zhvillim te dukshem te pyjeve apo drureve frutore,mbasi mungon vegjatacioni (subjekti ka mbjell vete bime qe rriten ne zone).
- Ndikim te pritshem do te kete vetem ne ndryshimin e pjeseshem ne toke ,te peisazhit te zones qe me masat qe jane parashikuar ne terren do te zbusin kete fenomen dhe do te çojne ne permiresimin e metejshem te tij.
- Vendin e sipërfaqes se zhveshur do ta zeje nje sipërfaqe e pyllezuar.
- Aktiviteti i depozitimit, seperimit dhe asgjесimit te vajrave te perdorur qe vijne nga pastrami detar Durres ne objekt do te kete inpakt pozitiv mbasi do te ndihmoje ne hapjen e vendeve te reja te punes.

RADA OIL INDUSTRY

ANEKSI 1


- 02 01 04 Mbetje të lëndëve plastike (me përjashtim të ambalazheve)
- 03 03 07 Mbetje skarco të ndara mekanikisht që vijnë nga pulpëzimi i mbetjeve të letrës dhe të kartonit
- 03 03 08 Mbetje që dalin nga seleksionimi i letrave dhe kartonëve të destinuar për riciklim
- 04 02 09 Materiale të përziara (tekstile të imprenjuara, elastomere, plastomere)
- 05 01 Mbetje që vijnë nga rafinimi i naftës
- 05 01 02*Llumra të shkripëzimit
- 05 01 03*Llumra të fundit të depozitave
- 05 01 04*Llumra të alkileve acide
- 05 01 05*Derdhje naftë të shpërndarë aksidentalisht
- 05 01 06*Llumra të naftës që dalin nga operacionet e mirëmbajtjes së impiantit apo pajisjeve
- 05 01 07*Mbetje zifti acide
- 05 01 08*Mbetje zifti të tjera dhe bitume
- 05 01 09*Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 05 01 10 Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 05 01 09
- 05 01 11*Mbetjet që vijnë nga pastrimi i lëndëve djegëse me baza (alkale)
- 05 01 12*Nafta që përmbajnë acide
- 05 01 13Llumra të dala nga trajtimi i ujit ushqyes të kaldajave
- 05 01 14 Mbetjet që vijnë nga kolonate ftohjes
- 07 02 13 Mbetje Plastike
- 08 01 11 * Mbetje të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 08 01 12 Mbetje të bojërave dhe llaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 08 01 11



12 01 05 Mbetje plastike nga format dhe tornimet
12 01 12 * Parafinat dhe yndyrat e shpenzuara
13 01 Mbetje vajrash hidraulike
13 01 01*Vajra hidraulike që përmbajnë PCB
13 01 04*Tretsa të kloruar
13 01 05*Tretsa të paklorinuar
13 01 09*Vaj hidraulik i klorinuar me bazë minerale
13 01 10*Vaj hidraulik i paklorinuar me bazë minerale
13 01 11*Vajra hidraulike sintetike
13 01 12*Vajra hidraulike lehtësisht të biodegraduar
13 01 13*Vajra të tjerë hidraulikë
13 02 Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante
13 02 04*Vajra motori ingranazhesh dhe lubrifikues të klorinuar me bazë minerale
13 02 05*Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të pa klorinuar me bazë minerale
13 02 06*Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues
13 02 07*Vajra lehtësisht të biodegradueshme: motori, ingranazh i dhe lubrifikant.
13 02 08*Vajra të tjera motori, ingranazhi delubrifikante
13 03 Mbetje vajrash izolues dhe përcjellës nxehtësie
13 03 01* Mbetje vajrash izolues dhe përcjellës nxehtësie që përmbajnë PCB
13 03 06* Mbetje vajrash izolues dhe përcjellës të nxehtësisë të klorinuar me bazë minerale, të tjerë nga ato të përmendura në 13 03 01
13 03 07* Vajra izolues dhe përcjellës të paklorinuar me bazë minerale
13 03 08*Vajra izolues, përcjellës nxehtësie dhe sintetik
13 03 09*Vajra lehtësisht të biodegradueshme izolues dhe përcjellës nxehtësie
13 03 10*Vajra të tjerë izolues dhe përcjellës nxehtësie
13 04 Vajra të ndotur anijesh



- 13 04 01*Vajratë ndotur anijesh nga lundrimi pranë tokës
- 13 04 02* Vajra nga ujëra të zeza të bankinave
- 13 04 03* Vajra të ndotur nga lundrime të tjera
- 13 05 Përbërës të separetove ujit/naftë
- 13 05 01*Pjesë të ngurta nga separetoret ujë/naftë
- 13 05 02*Llumra nga separetoret ujë/naftë
- 13 05 03*Llumra ndërmjetës
- 13 05 06*Naftë nga separetorët ujë/naftë
- 13 05 07*Ujë me naftë nga separetorët ujë/naftë
- 13 05 08*Përzierje mbetjesh nga separetorët ujë/naftë
- 13 07 Mbetje të karburanteve të lëngshme
- 13 07 01*Naftë dhe diesel
- 13 07 02*Benzinë
- 13 07 03*Lëndë të tjera djegëse përfshi edhe përzierjet
- 13 08 Mbetje naftë të paspecifikuara diku tjetër
- 13 08 01*Llumra nga shkripëzimet ose emulsionet
- 13 08 02*Emulsione të tjerë
- 13 08 03*Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 15 01 02 Mbetje ambalazhi plastike
- 15 01 03 Mbetje ambalazhi druri
- 15 01 07 Mbetje ambalazhi qelqi
- 15 01 10 * Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme
- 16 01 19 Plastika
- 16 03 05 * Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 16 06 01 * Bateri plumbi
- 16 07 09 * Mbetje që kanë substanca të tjera të rrezikshme



17 01 01 Beton

17 01 02 Tulla

17 01 03 Tjegulla dhe qeramika

17 01 07 Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06

17 02 01 Dru

17 02 02 Qelqe

17 04 01 Bakër, bronz, tunxh

17 04 02 Alumin

17 04 05 Hekur dhe çelik

17 04 07 Metale të përziëra

17 05 03 * Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme

17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03

19 09 02 Llumra nga qartësimi i ujit

19 12 01 Letër e karton

19 12 05 Qelq

20 01 01 Letër dhe karton

20 01 02 Qelq

20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat

20 01 10 Veshjet

20 01 11 Tekstilet

20 01 21 * Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur

20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37

20 01 39 Plastikët

20 01 40 Metalet

20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve

20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara



- 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme
- 20 02 02 Dhera dhe gurë
- 20 02 03 Mbetje të tjera të pabiodegradueshme
- 20 03 Mbetje të tjera urbane
 - 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane
 - 20 03 02 Mbetje nga tregjet
 - 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve
 - 20 03 04 Llumra nga gropat septike
 - 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza
 - 20 03 07 Mbetjet të vëllimshme
 - 20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara

Plavcat Gjiraxhi

